VENDIM
Nr.629, datë 8.7.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.455, DATË 18.7.2007 "PËR PAGAT DHE SHTESAT MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PYJOR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 "Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e shërbimit pyjor", që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave për vitin 2010.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT PYJOR

Nr.	**KLASA**	**Paga bazë mujore në lekë**
1.	I	19 000
2.	II	19 250
3.	III	19 550
4.	IV	19 850
5.	V	20 160
6.	VI	20 480
7.	VII	21 550
8.	VIII	22 550
9.	IX	23 100
10.	X	24 150
11.	XI	25 200
12.	XII	25 750
13.	XIII	26 250
14.	XIV	27 300
15.	XV	29 400
16.	XVI	30 450
17.	XVII	32 050
18.	XVIII	33 100
19.	XIX	33 600

20.	)(X	34 650
21.	XXI	36 750
22.	XXII	37 800
	XXIII	39 900